

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 40492/20

Sabri HOXHA

kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 16 shtator 2025, si Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *President,*

Darian Pavli,

Mateja Đurović, *gjyqtarë,*

dhe Olga Chernishova, *zëvendëskancelar i Seksionit,*

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 40492/20) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) më 31 gusht 2020 nga shtetasi shqiptar z. Sabri Hoxha ("kërkuesi"), i lindur në vitin 1971, me banim në Tiranë dhe që u lejua të përfaqësojë veten përpara Gjykatës;

vendimin për të njoftuar qeverinë e Shqipërisë (qeveria) të përfaqësuar nga agjenti z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit, për ankimin në lidhje me mungesën e arsytimit të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

parashtrimet e palëve;

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

OBJEKTI I ÇËSHTJES

1. Kërkesa ka të bëjë me proceset përpara gjykatave administrative, të nisura nga kërkuesi kundër punëdhënësit të tij të mëparshëm, ku kundërshton shkarkimin e tij dhe kërkon dhënien e pagave për një periudhë të caktuar. Gjykata e shkallës së parë i pranoi pjesërisht pretendimet e kërkuesit dhe rrëzoi kërkesat e mbetura.

2. Bazuar në ankimin e kërkuesit, Gjykata Administrative e Apelit la në fuqi vendimin e shkallës së parë pjesërisht dhe e përmbysi atë pjesërisht.

3. Kërkuesi ankohet sipas nenit 6 që gjykimi ishte i padrejtë sepse gjykata e apelit nuk dha ndonjë arsye për rrëzimin e kërkesave të tij.

4. Vendimi përfundimtar në këto procese u mor nga Gjykata Kushtetuese më 29 janar 2020. Ai ju njoftua kërkuesit më 3 shkurt 2020.

5. Kërkuesi më pas depozitoi një ankim tjetër kushtetues për të kundërshtuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Më 29 prill 2020, Gjykata Kushtetuese shpalli të papranueshme kërkesën e dytë kushtetuese të kërkuesit me arsyen që nuk ishte e mundur të kundërshtohet vendimi i saj përfundimtar i datës 29 janar 2020.

VLERËSIMI I GJYKATËS

6. Gjykata vëren që Gjykata Kushtetuese e mori vendimin përfundimtar në këtë çështje më 29 janar 2020. Qeveria parashtroi që ky vendim i ishte njoftuar kërkuesit më 3 shkurt 2020, fakt ky që kërkuesi nuk e kundërshtoi. Kërkuesi depozitoi kërkesën e tij përpara Gjykatës më 31 gusht 2020, jashtë afatit kohor 6-mujor. Ankimi i dytë kushtetues i kërkuesit, që kundërshtonte vendimin e Gjykatës Kushtetuese, nuk ishte një mjet ligjor që duhej shteruar.

7. Në këto rrethana, kërkesa është depozituar jashtë afatit dhe duhet të refuzohet në përputhje me nenin 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

Për këto arsye, Gjykata, unanimit, *Shpall* kërkesën të papranueshme.
Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 9 tetor 2025.

Olga Chernishova
ZËVENDËSKANCELAR NË DETYRË

Úna Ní Raifeartaigh
PRESIDENT